- E drejta për të kërkuar në Bashki, nëpërmjet organizatës BID, të rregullojë një zonë këmbësorësh brenda zonës BID, nëse është e mundur, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Në detyrimet e pagesve të kuotës BID përfshihet detyrimi për të paguar kuotën BID dhe çdo detyrim tjetër të parashikuar në prospektin BID.]

12. Informacion mbi financimet që do të japë bashkia, sipas angazhimeve përkatëse gjatë autorizimit të BID-it përkatës, si dhe informacion mbi planet afatmesme buxhetore (PBA) të miratuara nga Këshilli Bashkiak para datës së njoftimit të prospektit.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përshkruani nëse parashikohet që Bashkia të japë financim për BID-in për të mbështetur Planin e biznesit të propozuar me propozimin për BID, bazuar në informacionin që disponojnë propozuesit e BID-it mbi planet afatmesme buxhetore (PBA) të bashkisë përkatëse ose propozimin për BID, për të cilin bashkia ka lëshuar autorizimin.]

13. Organizimi ligjor, strukturat e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive të organizatës BID që do të administrojë fondin BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përcaktoni cila do të jetë organizata BID që do të administrojë fondin BID: nëse është një organizatë që do të themelohet rishtazi apo një organizatë ekzistuese, përshkruani formën e organizimit të organizatës BID, sipas një prej formave të përcaktuara në ligjin për organizatat jofitimprurëse, strukturën dhe përbërjen e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive të saj, mënyrën e zgjedhjes së tyre, organizimin e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve, organet konsultative apo të tjera lidhur me administrimin e fondit BID, si dhe publikimin e vendimeve të marra nga organizata BID. Për rastin kur është rënë dakord që organizata BID që do të administrojë fondin BID të jetë një organizatë jofitimprurëse ekzistuese, propozuesi i BID-it deklaron organizatën ekzistuese, dhe përshkruan angazhimin e marrë nga organizata ekzistuese për të vepruar si organizata BID, në përputhje me prospektin BID, sipas marrëveshjes formale të nënshkruar me këtë organizatë. Përcaktoni kushtet e shpërndarjes së organizatës BID, të cilat do të pasqyrohen në statutin e organizatës BID, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.]

14. Shpjegim nëse ndonjë nga shpenzimet e kryera për zhvillimin e propozimit për BID, kryerjen e njoftimit ose zbatimin e BID-it do të mbulohen nga kuota BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përcaktoni nëse shpenzimet e kryera nga propozuesit e BID-it do të mbulohen nga fondi BID. Ky përcaktim nuk mund të ndryshojë nga ai i kryer në propozimin për BID, për të cilin është marrë autorizimi nga bashkia përkatëse.]

15. Mënyrën e përgatitjes, botimit dhe qarkullimit të prospektit BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përshkruani procesin e përgatitjes, këshillimeve të kryera, shpalljes dhe njoftimit të prospektit BID pranë personave me të drejtë vote në zonën BID.]

16. Mënyra e njoftimit dhe votimit të ndryshimit të prospektit BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Cdo ndryshim i prospektit BID, përfshirë ndryshime të kuotës BID, strukturës së organizatës BID apo ndryshime të tjera gjatë kohëzgjatjes së BID-it, do t'i nënshtrohet së njëjtës procedurë njoftimi dhe votimi që zbatohet për propozimin dhe miratimin e një prospekti të ri BID. Në këtë rast, organizata BID do të hartojë propozimin për ndryshimin e prospektit BID, sipas diskutimeve dhe vendimit të marrë në organin e saj vendimmarrës apo me kërkesë të çdo paguesi të kuotës BID. Organizata BID njofton dhe publikon njoftimin për ndryshime të prospektit BID në media, e afishon atë në mënyrë të dukshme në hapësirat publike të zonës BID dhe në vendin e njoftimeve të bashkisë përkatëse, si dhe njofton me postë njoftimin për ndryshimin e prospektit BID pranë bashkisë përkatëse dhe në selinë e regjistruar të çdo paguesi të kuotës BID. Njoftimi për ndryshimin e prospektit BID përmban përmbledhje të ndryshimeve të prospektit BID, si dhe informacion mbi vendin ku mund të dorëzohen formularët për votimin e prospektit BID dhe procedurat e votimit.]

17. Mënyrën e njoftimit të ripërtëritjes së kohëzgjatjes së BID, nëse do të jetë i zbatueshëm.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përshkruani procedurat e miratimit për zgjatjen e afatit të BID-it. Për ripërtëritjen e kohëzgjatjes së BID-it, organizata BID duhet të ndjekë të njëjtën procedurë si për miratimin fillestar të një BID-i, ka të drejtën të kërkojë nga paguesit e kuotës BID zgjatjen e afatit të BID-it. Në rast të miratimit të ripërtëritjes së kohëzgjatjes së BID-it nga shumica e personave me të drejtë vote, organizata BID merr konfirmimin përkatës të bashkisë, sipas të njëjtave procedura të ndjekura për miratimin fillestar të një BID-i. Zgjatja e afatit të BID-it duhet t'i nënshtrohet së njëjtës procedurë të përcaktuar në ligjin nr. 63/2020 për miratimin e BID-it.]

18. Mënyra e njoftimit të BID-it të miratuar dhe krijimit të organizatës BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përshkruani mënyrën e njoftimit të BID-it të miratuar të të gjithë paguesit e kuotës BID. Në vijim të votimit të prospektit BID, në rast të miratimit të BID-it, propozuesit për BID detyrohen të njoftojnë të gjithë paguesit e kuotës BID për këtë fakt dhe për fillimin e themelimit të organizatës BID ose të pajtimit të një organizate jofitimprurëse ekzistuese, sipas përcaktimeve të pikës "h" më sipër. Mënyra e njoftimit mund të kryhet sipas të njëjtave procedura si njoftimi për BID.

Propozuesi i BID-it deklaron se do të nisë procesin e themelimit dhe të regjistrimit të organizatës BID në gjykatën kompetente, brenda 90 ditëve kalendarike nga data e miratimit të prospektit BID, nëse e zbatueshme. Në rastin kur në pikën "h" më sipër është parashikuar që BID-i të administrohet nga një organizatë jofitimprurëse ekzistuese, përcaktoni afatet brenda të cilave duhet të pajtohet/kontraktet organizata BID e përcaktuar shprehimisht në prospektin BID.]

19. Afati brenda të cilit organizata BID do të lidhë marrëveshjen operationale me bashkinë përkatëse, në përputhje me dispozitat e prospektit BID.

Dokumentacion shtesë bashkëlidhur:
Po ☐ Jo ☐

Përshkrim:

[Përcaktoni afatin brenda të cilit do të lidhet marrëveshja operationale me bashkinë përkatëse.]

**URDHËR**

Nr. 243, datë 8.6.2021

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË,
NË MJEDISËT E HAPURA DHE
TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, germa “b”, e nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtisë së shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi**

NJOFTIM

Nr. 6973, datë 9.6.2021

**MBI NJOFTIMIN PËR HAPJEN E
ZYRËS SË FAO-së NË TIRANË**

Me anë të notës verbale nr. 21/35, datë 3 qershor 2021 (bashkëlidhur), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO) ka përcjellë njoftimin, se: “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), për krijimin e një përfaqësie të FAO-së në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruar më 1.10.2014, ka hyrë në fuqi më 12 prill 2021, sipas nenit 12 të marrëveshjes.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi**



منظمة
الأغذية والزراعة
للأمم المتحدة

联合国
粮食及
农业组织

Food and Agriculture
Organization of the
United Nations



Organisation des
Nations Unies pour
l'alimentation et
l'agriculture

Продовольственная и
сельскохозяйственная
организация
Объединенных Наций

Organización de las
Naciones Unidas para la
Alimentación y la
Agricultura

MEPT-

Viale delle Terme di Caracalla, 00153 Rome, Italy

Fax: +39 0657053152

Tel: +39 0657051

www.fao.org

Our Ref.: LEG 21/35

Your Ref.:

NOTE VERBALE

The Food and Agriculture Organization of the United Nations (hereinafter referred to as "FAO" or "the Organization") presents its compliments to the Embassy of the Republic of Albania in Rome, and has the honour to refer to its Note Verbale No. 297 dated 8 April 2021, whereby, pursuant to paragraph 1 of Article XII of the Agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and FAO for the establishment of an FAO Representation Office in the Republic of Albania, signed on 1 December 2014 (hereinafter referred to as "the Agreement"), the Government of the Republic of Albania notifies to the Organization that the necessary internal legal requirements for the entry into force of the Agreement have been fulfilled.

The Organization expresses its appreciation to the Government of Albania for the finalization of the ratification of the Agreement, and hereby confirms receipt of the above-mentioned notification on 12 April 2021 and further confirms that, pursuant to paragraph 1 of Article XII of the Agreement, the latter is in force as from 12 April 2021.

The Food and Agriculture Organization of the United Nations avails itself of this opportunity to renew to the Embassy of the Republic of Albania in Rome the assurance of its highest consideration.

Rome, 3 June 2021



Embassy and Permanent Representation
of the Republic of Albania
Rome
Italy



VENDIM
Nr. 119, datë 11.5.2021

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL SHA, NË CILËSINË E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN PRILL 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 68/9 prot., datë 7.5.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), me shkresën e saj nr. 5020 prot., datë 6.5.2021, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

për muajin prill 2021, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, për vitin 2021, janë vlerësuar sa ato të vitit 2020.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021” është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 199, datë 12.12.2019, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit për vitin 2021”, është 1.5 lekë/kWh.

- Sasia e energjisë elektrike e prokuruar në treg të parregulluar dhe nga burimet e rinovueshme është 1,554 mWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e shoqërisë FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Prill 2021

Prill 2021		Aplikimi FSHU sh.a.		Përllogaritjet e ERE
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	6.343	6.343
Fr	Kohimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.19	0.19
	Çmimi mesatar i blerjes në prodhuesit relevante	Leke/kWh	6.53	6.53
CA	Kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt + Fr* CBEt + TRrTSHt+CA		Leke/kWh	10.57	10.57



- Për sa përcaktohet për çdo element të formulës përlogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionet e procedurës së blerjes së energjisë nga shoqëria FSHU sh.a., furnizuesi i tregut të lirë, si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2021, të jetë 10.57 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga shoqëria FSHU sh.a. në cilësinë e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit prej 10.57 lekësh/kwh, për muajin prill 2021.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 120, datë 11.5.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 15, DATË 31.1.2019, “MBI LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR TË ‘TRANS ADRIATIC PIPELINE AG ALBANIA’, E REGJISTRUAR PRANË QKB-së SI DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ AKSIONARE (SHA), ‘TRANS ADRIATIC PIPELINE AG’”

Në mbështetje të nenit 4, pika 50 dhe të nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 3, pika 1, germa “a” dhe të nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të

Republikës së Shqipërisë”, të miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, të ndryshuar; të nenit 9, pika 1, germa “e”, “iv”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 68/2 prot., datë 5.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 15, datë 31.1.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur:

“1. Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror ‘Trans Adriatic Pipeline AG Albania’, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) si Degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), ‘Trans Adriatic Pipeline AG’, për një afat 25-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.

2. Jo më vonë se 12 muaj nga fillimi i operimit të gazsjellësit, shoqëria të paraqesë në ERE dokumentacionin e plotë, që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar në territorin e Shqipërisë.

3. Në rastin e mospërbushjes së këtij kushti nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 21/67 prot., datë 9.12.2020, shoqëria “Trans Adriatic Pipeline Albania” (TAP AG Albania) ka bërë një përditësim në kuadër të përbushjes së kushteve të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, dhe ka depozituar në shqip dhe anglisht një certifikatë sigurimi për shoqërinë “TAP AG Albania”, me afat 1-vjeçar, nga data 15.11.2020 deri në datën 15.11.2021. Po ashtu, shoqëria ka shpjeguar se “TAP AG Albania” përjashtohet nga detyrimi për të raportuar, për një plan 10-vjeçar zhvillimi të mirëmbajtjes së rrjetit.

- Nga konstatimet e vendimit nr. 15/2019, për sa i përket përbushjes nga ana e shoqërisë “TAP



AG Albania” të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, në lidhje me certifikatën e sigurimit, neni 9, pika 1, germa “e”, “iv”, rezulton se kjo pikë është plotësuar nga shoqëria “TAP AG Albania” gjatë procesit të licencimit.

- Duke marrë në konsideratë se vetë dokumenti ka përcaktuar një afat vlefshmërie prej një viti, atëherë, në përfundim të vlefshmërisë së tij, duhet të vijohet me depozitim të një certificate sigurimi të re me afatet respektive.

- Në këtë kuadër, shoqëria ka përcjellë në ERE dhe certifikatën e sigurimit me një afat vlefshmërie 1-vjeçar, deri më 15.11.2021, për rrjedhojë vlerësohet që në vendimin nr. 15/2019, të shtohet kushti që shoqëria të përcjellë në mënyrë periodike në ERE certifikatën e sigurimit, të rinovuar.

- ERE iu drejtua shoqërisë “TAP AG Albania” me shkresën nr. 502 prot., datë 31.3.2021, ku përveç argumentimit dhe propozimit për sa më sipër, i kërkoj që të paraqesë në ERE komentet apo objeksionet e saj të mundshme, për sa propozuar për t’u shtuar si kusht periodik në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 596 prot., datë 15.4.2021, shoqëria “TAP AG Albania” është shprehur se mirëkupton nevojën e ERE-s për të nisur procesin e ndryshimit të licencës së transmetimit, lidhur me detyrimet e TAP-it për dorëzimin e certifikatave (policave) të sigurimit në mënyrë periodike, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, është parashikuar kompetenca e organit publik për të ndryshuar kryesisht një akt të nxjerrë nga vetë ai, duke respektuar formën e kërkuar për aktin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, pas pikës 2, të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2.1 Shoqëria “TAP AG Albania” të përcjellë periodikisht në ERE certifikatën (policën) e sigurimit, pas rinovimit të saj, sipas kërkesave të nenit 9, pika 1, germa “e”, “iv”, të “Rregullores për

procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TAP AG Albania” për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 121, datë 11.5.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 436,
SERIA TGN19, PËR AKTIVITETIN E
TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR,
DHËNË “TRANS ADRIATIC PIPELINE
AG ALBANIA”, ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE- s NR. 15,
DATË 31.1.2019**

Në mbështetje të nenit 4, pika 50, nenit 23, pika 1, germa “a”, dhe nenit 35, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 5, nenit 9, pika 2, germa “a” dhe germa “x”, nenit 9, pika 2, germa “a”, “xvii”, si dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 68/8 prot., datë 7.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror, konstatoi se:



- Me vendimin nr. 15, datë 31.1.2019, Bordi i ERE-s ka vendosur: “Të licencojë në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, ‘Trans Adriatic Pipeline AG Albania’, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) si degë e shoqërisë së huaj aksionare (sh.a.), ‘Trans Adriatic Pipeline AG’, për një afat 25-vjeçar, nga data e fillimit të operimit.”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 596 prot., datë 15.4.2021, shoqëria “Trans Adriatic Pipeline AG Albania” (TAP AG Albania) ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e kohëzgjatjes së licencës së transmetimit të gazit natyror, nga 25 vjet deri në 30 vjet, duke e bazuar këtë kërkesë në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe në nenin 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Shoqëria “TAP AG Albania” shprehet se zgjatja e afatit të licencës së transmetimit nga 25 vjet deri në 30 vjet, do të siguronte harmonizimin e licencës së transmetimit me lejen e veçantë të dhënë TAP-it, me VKM-në nr. 123, datë 13.3.2019, duke theksuar se sipas nenit 5.2, të ligjit nr. 116/2013, datë 15.4.2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, të ndryshuar, leja e veçantë rinovohet automatikisht nga Autoritetet Shqiptare, në përfundim të periudhës 30-vjeçare, më konkretisht më 21.3.2049. Gjithashtu, jetëgjatësia minimale operationale teknike e sistemit të transmetimit të gazit natyror të TAP-it është 50 vjet.

- Në zbatim të nenit 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, vlerësohet pranimi i

kërkesës së shoqërisë “TAP AG Albania” dhe fillimi i procedurës për modifikimin e licencës së saj për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, për sa i përket kohëzgjatjes, nga 25 vjet deri në 30 vjet, por duke mbajtur në konsideratë faktin se për 5 vitet e tjera (si referuar kërkesës së vetë subjektit), shoqëria nuk është subjekt i përjashtimit.

- Nga shqyrtimi i kësaj kërkesë, rezulton se subjekti ka plotësuar kryesisht kërkesat e nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

Neni 13, pika 4:

a. tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar, plotësuar;

b. informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të licencës, plotësuar;

c. vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të licencuarit për ndryshimin specifik të licencës, paplotësuar.

Shoqëria “TAP AG Albania” nuk e ka depozituar këtë dokument në ERE, por do t’i kërkohej që ta depozitojë atë pas fillimit të procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës nr. 436, seria TGN19, për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, dhënë “Trans Adriatic Pipeline AG Albania”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 31.1.2019, për ndryshimin e afateve të kohëzgjatjes së saj nga 25 vite në 30 vjet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TAP AG Albania”, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



VENDIM
Nr. 123, datë 11.5.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 13,
DATË 20.1.2021, PËR RINOVIMIN E
LICENCËS SË SHOQËRISË ENERGY
SUPPLY - AL” SHPK, NR. 115/309, SERIA
T11/T15, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 prot., datë 4.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 13, datë 20.1.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 13, datë 20.1.2021, vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 115/309, seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitojë në ERE:

a. vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë;

b. dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë, që ka marrë përsipër të mbështesë

shoqërinë “Energy Supply - AL”, apo strukturën e financimit.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën nr. 299/6, datë 21.4.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 13/2021, rezulton si më poshtë:

- Kushti i vendosur në pikën 1, germa “a”, “vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë”, të vendimeve nr. 13/2021 dhe nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.

- Kushti i vendosur në pikën 1, germa “b”, “dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë, që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply - AL”, apo strukturën e financimit”, të vendimit nr. 13/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 13, datë 20.1.2021, si vijon:

Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 115/309, seria T11/T15, të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

2. Germat: “a” dhe “b”, të pikës 1 dhe pika 2, të vendimit nr. 13/2021, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 124, datë 11.5.2021

MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 14,
DATË 20.1.2021, “MBI RINOVIMIN E
LICENCËS SË SHOQËRISË ‘ENERGY
SUPPLY - AL’ SHPK, NR. 115/310, SERIA
F11/FK15, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.5.2021, pasi shqyrtoi relacionin nr. 68/1 prot., datë 4.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me plotësimin e kushteve të vendimit nr. 14, datë 20.1.2021, mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 14, datë 20.1.2021, vendosi:

“1. Të rinovojë licencën e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, datë 2.2.2011, për një afat 5-vjeçar, duke

filluar nga data 4.2.2021, me kusht që përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar të depozitohet në ERE:

a. vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë;

b. dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply - AL” sh.p.k. apo strukturën e financimit;

c. sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët, për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi;

d. dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, pasi të analizohet dokumentacioni i përcjellë nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k. sipas kërkesave të pikës 1, të këtij vendimi.”.

-Në vijim të sa më sipër, ERE iu drejtua shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën nr. 128 prot., datë 26.1.2021, duke i njoftuar vendimet përkatëse.

- Shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1855/5 prot., datë 29.1.2021, ka përcjellë argumente dhe një pjesë të dokumentacionit, në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit. Duke qenë se u konstatua ende mungesë, ERE iu drejtua sërish shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k. me shkresën nr. 299, datë 11.2.2021, ku i ka kërkuar sërish plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me kushtet e vendimeve të rinovimit të licencave. Shoqëria vijoi plotësimin kryesisht të dokumenteve, në përmbushje të kushteve të vendimeve të rinovimit të licencave të saj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/1 prot., datë 16.2.2021. Duke qenë se nevojitej ende dokumentacion, ERE, me shkresën nr. 299/2 prot., datë 25.2.2021, iu drejtua sërish shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k.. Kjo e fundit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 299/4 prot., datë 11.3.2021, përcolli një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe si e tillë ERE iu drejtua sërish me shkresën nr. 299/5, datë 29.3.2021, duke përsëritur kërkesën e saj. Në përgjigje të sa kërkuar, shoqëria “Energy Supply -



AL” sh.p.k., me shkresën nr. 299/6, datë 21.4.2021, përcolli dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë në ERE nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k., në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimeve nr. 13/2021 dhe nr. 14/2021, rezulton si më poshtë:

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “a”, “Vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply -AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “b”, “Dokumentacion vërtetues ku të shprehen qartë vlerat monetare dhe aftësia paguese e shoqërisë mëmë që ka marrë përsipër të mbështesë shoqërinë “Energy Supply - AL”, apo strukturën e financimit”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “c”, “Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi”, të vendimit nr. 14./2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.;

- kushti i vendosur në pikën 1, germa “d”, “Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve”, të vendimit nr. 14/2021, është plotësuar nga shoqëria “Energy Supply - AL” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 1, të vendimit të ERE-s nr. 14, datë 20.1.2021, si vijon:

Të rinovojë licencën e shoqërisë “Energy Supply - AL” sh.p.k., me nr. 115/310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 5, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 123, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

2. Germat: “a”, “b”, “c”, “d”, të pikës 1 dhe pika 2, të vendimit nr. 14/2021, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 583 datë 6.10.2020, ka vendosur shpalljen të zhdukur të shtetasit Gentian Ndreu, lindur më datën 3.10.1973, dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij shtetasen Regina Ndreu.

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 22.4.2021, “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me vendimin e ERE-s nr. 60, datë 25.2.2021”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 78, datë 25.5.2021, pika 2 bëhet:

“Pezullimin e zbatimit të afateve të parashikuara në vendimin e ERE-s nr. 60/2021, “Mbi miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”, për shoqërinë OSSH sh.a., për një periudhë 45-ditore nga marrja dijeni e këtij vendimi.”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë